



Republika e Kosovës
Republika Kosovë - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Shërbimi Korrektues i Kosovës / Korrektivna Sluzba Kosova / Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

Prishtinë: 06.02.2026

NJOFTIM PËR PUBLIKUN

LIDHUR ME PRONONCIMIN PËR MEDIA TË PERSONAVE QË GJENDEN NË MBAJTJE NË INSTITUCIONET KORREKTUESE

Shërbimi Korrektues i Kosovës bazuar në nenin 64, paragraf 4 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës si dhe dispozitave tjera që rregullojnë funksionimin e institucioneve korrektuese, njofton publikun se zhvillimi i intervistave, dhënia e deklaratave dhe çdo formë tjetër e komunikimit me media i personave të burgosur të cilët gjenden në mbajtje në institucionet korrektuese duhet të bëhet në përputhje me ligjin e lartpërmendur dhe për këtë duhet të ketë pëlqim nga i burgosuri si dhe aprovim paraprak nga Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës.

Aprovimi paraprak i intervistave me persona të burgosur ka për qëllim:

- Ruajtjen e rendit dhe sigurisë brenda institucioneve korrektuese;
- Mbrojtjen e konfidencialitetit të personave të burgosur;
- Parandalimin e rrezikimit të sigurisë publike dhe institucionale;
- Mbrojtjen e dinjitetit të viktimave dhe interesit publik;
- Respektimin e procedurave dhe standardeve ligjore.

Kërkesat nga mediat për intervistë apo komunikim me personat e burgosur që janë në mbajtje në institucionet korrektuese do të trajtohen me kujdes dhe në përputhje me procedurat ligjore në fuqi duke u siguruar se do të aprovohen vetëm kërkesat që nuk kanë ndikim negativ në menaxhimin e burgjeve, të burgosurit tjerë dhe lëndim të mëtejshëm të familjeve të viktimave apo ndikimin e mundshëm në procedurat tjera penale që mund të jenë në zhvillim nga organet kompetente.

Mosrespektimi i këtij njoftimi përbën shkelje dhe mund të sjellë pasoja ligjore.

Faleminderit për vëmendje!



Ismail Dibrani
Drejtori i Përgjithshëm
Shërbimi Korrektues i Kosovës